

## KOMITETI DREJTUES

Nr. 20 Prot.

Tiranë, 10 Mars 2025

### Vendim Nr. 1 i KD-së

Komiteti Drejtues i FSHB-së në mbledhjen e sajë më datë 6 mars 2025, drejtuar nga Presidenti, z. Avni Ponari, me prezencë të anëtarëve, znj. Migena Plasa, z. Blendi Dibra, si dhe z. Klevis Kaso, duke formuar kuorumin e domosdoshëm për zhvillimin e mbledhjes, diskutuan mbi rendin e ditës si vijon:

1. **Raport mbi aktivitetet kombëtare** – Përfundimi i Ligës Amatore dhe organizimi i ndeshjeve finale për moshat.
2. **Regjistrimi i lojtarëve në ekipet e moshave** – Çështjet që lidhen me:
  - Regjistrimin për herë të parë të lojtarëve;
  - Regjistrimet brenda të njëjtës shoqatë, por në kategori të ndryshme;
  - Lojtarët që nuk figurojnë në listë, por kanë qenë më parë pjesë e të njëjtës shoqatë.
3. **Kërkesa e Goga Basket** – Kërkesa për të marrë pikët e ndeshjes kundër Teuta U18 djem (20-0) për shkak të mungesës së lojtarëve për arsye shëndetsore.
4. **Ndryshimi i përbërjes së Komisionit të Disiplinës.**
5. **Ndryshimi i adresës së FSHB-së.**
6. **Mbyllja e aktiviteteve ndërkombëtare për vitin 2024**, duke përfshirë ndeshjen e ekipit kombëtar meshkuj në shkurt 2025 – Raport.
7. **Kompetencat për marrje vendimi** në lidhje me gjykimin i delegohen instruktorit të gjyqtarëve.
8. **Plani i punës i FSHB-së për vitin 2025.**
9. **Aktivitet ndërkombëtare 2025. Organizimi i FIBA U16 dhe FIBA U18 EuroBasket 2025** – Detaje mbi aktivitetet që do të zhvillohen në Shqipëri. Përcaktimi i Trajnerëve për ekipet kombëtare të moshave 2025.
10. **Vendim për shpërndarjen e Fondit Grant 2025.**
11. **Projekti “Business Cup 2025”.**
12. **Ankimimi i ish-lojtarit Bruno Daliu** – Rishikimi i dënimit të tij.
13. **Të ndryshme.**

Komiteti Drejtues diskutoi sipas rendit të ditës, duke trajtuar problematikat për secilën pikë të tij.

**Për sa më sipër, KD-ja vendosi:**

1. **Miratimi i raporteve për aktivitetet kombëtare** të përfunduara për edicionin 2024-25. Udhëzim për administratën që të tregojë kujdes të shtuar në organizimin e aktiviteteve kombëtare në vijim.

2. **Miratimi për regjistrimin e lojtarëve** të cilët regjistrohen për herë të parë ose janë pjesë e së njëjtës shoqatë me ekipin pjesëmarrës.
3. **Refuzimi i kërkesës së Goga Basket**, duke nënvizuar rëndësinë e zbatimit të rregullores së lojës. KD tërheq vëmendjen e shoqatave që të sigurojnë mbarëvajtjen e ndeshjeve në kampionatet kombëtare, duke marrë në konsideratë problematikat dhe duke siguruar një numër të mjaftueshëm lojtarësh brenda listës së lejuar të ekipit.
4. **Komisioni i Disiplinës**
  - 4.1 Pranimi i dorëheqjes së z. Franko Bushati si anëtar i Komisionit të Disiplinës.
  - 4.2 Angazhimi i z. Ersi Oruçi si anëtar i Komisionit të Disiplinës.
5. **Miratimi i adresës zyrtare të FSHB-së** me të dhënat: “Rr. Myrtezim Këlliçi, Tiranë, 1001”.
6. **Miratimi i raportit për aktivitetet ndërkombëtare**, duke përfshirë ndeshjet e ekipit kombëtar të rritur meshkuj gjatë muajit shkurt 2025.
7. **Miratimi për delegimin e kompetencave** për marrjen e vendimeve në lidhje me gjykimin nga ana e instruktorit të gjyqtarëve. Trajtimi i çështjeve do të kryhet në bashkëpunim me Komisionin e Gjyqtarëve.
8. **Miratimi i Planit të Punës së FSHB-së për vitin 2025**, në funksion të aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe udhëzimeve të projektit FIBA Plus për periudhën 2024-26.
9. **Aktivitetet ndërkombëtare për vitin 2025**
  - 9.1 Miratimi i raportit për aktivitetet ndërkombëtare gjatë vitit 2025, si dhe ndryshimet e vendodhjeve të organizimeve FIBA U18 dhe U16 EuroBasket 2025, si më poshtë:

Nr.	Ekipi Kombëtar	Vendi Organizimit	Datat (2025)
1	U16 Vajza - EuroBasket Div. C	Pejë, Kosovë	8-13 Korrik
2	*U16 Djem - EuroBasket Div. C	*Korçë	5-13 Korrik
3	U20 Djem - EuroBasket Div. B	Yerevan, Armenia	11-20 Korrik
4	U18 Vajza - EuroBasket Div. C	Andorra La Vella	22-27 Korrik
5	*U18 Djem - EuroBasket Div. C	*Tiranë	19-27 Korrik
6	U20 Vajza - EuroBasket Div. B	Miskolc, Hungari	2-10 Gusht
7	Femra - Small Country	<i>*Organizim ne vitin 2026</i>	
8	Meshkuj	<i>*Pritet informacion nga FIBA</i>	
9	Ekip kombetar meshkuj 3x3	Prishtinë, Kosovë	7-8 Qershor
10	e-FIBA	<i>*Pritet informacion nga FIBA</i>	

9.2. **Përcaktimi i tre (3) trajnerëve** për secilin ekip kombëtar të moshave për vitin 2025, sipas vendimeve të Presidentit të FSHB-së.

10. **Miratimi i vendimit për shpërndarjen e Fondit Grant** të miratuar nga MAS për vitin kalendarik 2025.

11. **Miratimi i Projektit “Business Cup 2025”.**

12. **Heqja e dënimit për përjashtimin e z. Bruno Daliu** nga pjesëmarrja në aktivitetet basketbollistike, duke shfuqizuar vendimin e mëparshëm.

13. **Të ndryshme**

13.1 **Miratimi për rinovimin e marrëveshjes së bashkëpunimit** me kompaninë Genius Sport, e cila ofron shërbimin **FIBA LIVE STATS**, me të njëjtat terma si më parë.